

RREGULLORE

Rregullat e shkruara më poshtë janë ndërtuar për të siguruar një mardhënie të shëndetshme midis nxënësve, mësuesve dhe prindërve.

Regjistrimi

Të gjithë nxënësit që regjistrohen në Akademinë Hollywood, përpara leksionit të parë duhet të plotësojnë dhe firmosin aplikimin, të bëjnë një foto për sistemin tonë dhe të paguajnë kuotën e vendosur.

Depozita

Çdo nxënës që ndjek leksionet individuale muzikore, duhet të paguajë një depozitë sigurie minimale prej 2500 Lekë ose të barazvlefshme me 50% të tarifës mujore në të cilën është regjistruar. Depozita nuk kërkohet në klasat kolektive.

Pritshmëritë

Çdo javë Akademia Hollywood rezervon një fashë orari për leksionet tuaja. Në rast vonesash, nuk mund të shtyjme orën e leksionit, por mund të përftoni për aq sa ka ngelur.

Anullimet

Në rastin e anulimit të pedagogut/es tuaj Akademia Hollywood ofron mundësinë e një zëvendësuesi.

Zëvendësimet

Ju mund të zëvendësoni një leksion çdo **trimestër**, për të cilin keni lajmëruar 24 orë përpara. Në klasat kolektive dhe në paketat verore, zëvendësimet nuk aplikohen.

Largimet

Çdo nxënës që do të ndërpresë leksionet në Akademinë Hollywood, është i lutur të lajmërojë përpara muajit pasardhës. Nëse kërkon të ndërpresë leksionet në mes të muajit, pagesa do të mbahet e plotë.

Tarifat në Akademinë Hollywood

Tarifat e leksioneve individuale janë mujore, të përllogaritura për Trimestra.

Në çdo trimestër (Tetor - Dhjetor, Janar - 30 Mars, 31 Mars - 21 Qershor) Akademia Hollywood ofron 12 javë leksionesh në total. Pagesat kryhen javën e parë të çdo muaji, apo çdo trimestër. Konsultohuni me Kalendarin tonë vjetor.

Tarifat e Klasave Kolektive janë çdo 10 javë, parapagim dhe paketat verore janë 5 apo 10 leksione parapagim.

Sezoni Veror

Prej datës 21 Qershor, Akademia Hollywood ndryshon oraret dhe ditët e mësimdhënies dhe ndërpret pagesat mujore. Nga 22 Qershori, aplikohen vetëm paketat verore.

Uljet në Akademinë Hollywood

Akademia Hollywood ofron bursa për fëmijë të familjeve në nevojë, dhe gjithashtu për të gjithë familjarët aplikon uljet 10% për fëmijën e dytë, dhe 15% për fëmijën e tretë.

Për të gjithë nxënësit që ndjekin leksione kolektive dhe muzikore, përftojnë 10% ulje.

Pushimet Zyrtare / Situata të jashtëzakonshme

Akademia Hollywood nuk ndjek të njëjtat data pushimesh me kalendarët shkollorë. Për më tepër kontrolloni kalendarin tonë. Në raste të situatave të jashtëzakonshme, ju lutem kontaktoni me sekretarinë nëse do të zhvillohen apo jo leksionet.

Leje për foto apo video

Gjatë aktiviteteve të ndryshme Akademia Hollywood fotografon dhe xhiron eventet, si dhe leksionet. Ne nuk do të publikojmë asnjëherë pa marrë lejen tuaj në aplikimin e bërë.

Mirëmbajta

Akademia Hollywood ka të drejtën për të larguar nga leksionet cilido student që ka sjellje të pahijshme dhe të padisiplinuara; ka mungesa të shumta dhe ka vonesa të mëdha në pagesa.

Pritja

Ju lutem, të shoqëroni fëmijët tuaj deri në klasën e leksioneve të tyre. Akademia Hollywood nuk është përgjegjëse për ruajtjen e fëmijëve jashtë orarit të leksioneve të tyre.

Kontributet për shfaqjet

Akademia Hollywood organizon rreth 12 koncerte çdo vit. Në raste kur koncertet organizohen në salla me qera, apo ku kemi nevojë për kompani organizuese, kërkohet një kontribut për çdo pjesëmarrës.

Rregulla kundër diskriminit

Akademia Hollywood pranon nxënës pa dallim feje, gjinie, race, ngjyre, orientimi, kombësie, etj. dhe nuk toleron asnjë sjellje diskriminuese si nga nxënësit, mësuesit apo dhe prindërit.